



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

01 Nr. 07/21  
Rahovec, 30.07.2021

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më 30 korrik 2021 (e premte) me fillim në orën 10:00, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i Raportit financiar janar – qershor 2021;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpallje qytetar nderi z. Qemal Minxhozi;
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të jashtëm të komunës së Rahovecit për vitin financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2020;
6. Shqyrtimi i Raportit të DKA-së, për përfundimin e viti mësimor 2020 – 2021.





## Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



### *Kuvendi i Komunës Rahovec*

*Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec*

#### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.06.2021**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni t'iu përsënderes, i nderuar Kryetar i Komunës z. **Smajl Latifi**, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të LMT-së, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm!

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

#### REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021 – 2024;
4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit të Komunës për 6- mujorin e parë të vitit 2021;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal për Komunën e Rahovecit 2021 – 2025;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P – 7151005 – 01054 – 0 në zonën kadastrale në Krushë të Madhe;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për vënien në debat publik të Draft statutit për QKMF-në e Rahovecit;
8. Shqyrtimi i Raportit të performancës komunale për vitin 2020.

Të nderuar kolegë kuvendarë, a pajtoheni me rendin e ditës.

**Fehmi Hoxha** – Përsënderetje kryesues, nënkryetar, kuvendarë, drejtor të drejtorive, media, OSBE-ja dhe gjithë të pranishmit në sallë. Mendoj që në pikën e tretë, shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme

Buxhetore, duhet te jetë vetëm shqyrtim sepse nuk miratohet pasi është qarkorja e parë, ndoshta jam gabim mirëpo këtë drejtori duhet me ditë, mirëpo nëse vërtet duhet edhe qarkorja e parë me u aprovua atëherë gjithçka është në rregull.

**Kryesuesi** – E qesim në votim rendin e ditës. Konstatohet se unanimisht provohet rendit i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Atëherë nëse nuk ka diçka rreth procesverbalit, e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

**2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.**

**Fehmi Hoxha** – Unë kam një kërkesë, pasi kam dëgjuar që në disa lokalitete janë vendosur pllakat me mbishkrimin shtëpi-shkollë të viteve 90-ta. Kështu që është shumë mirë ajo që është bërë dhe kam kërkesë që të vendosen edhe në Rahovec pasi kemi dy xhamia të cilat kanë qenë shkolla në kohën e okupimit, si xhamia e Kosumëve dhe xhamia e Sokolëve si dhe janë edhe disa shtëpi si shtëpia e Rabëve dhe shtëpia e Sokolëve. Është mjaft e rëndësishme dhe e përgëzoj për iniciativën por duhet të vazhdohet kjo edhe në Rahovec që të vendosen këto pllaka me mbishkrimin shtëpi- shkolla dhe në të gjitha shtëpitë në tërë territorin e komunës së Rahovecit.

**Ali Morina** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtor të drejtorive komunale, kuvendarë dhe gjithë ju të pranishëm. Unë pata me ngritë një çështje në fshatin Ratkoc, konkretisht në rrugën Valon Hoti që shkon ka hekurudha në drejtim të separacioni për në lumin Drini i Bardhë. Është një shqetësim që është ngritur nga banorët e asaj pjese si kryqëzimi i rrugës që shkon në drejtim të separacionit dhe rrugës kryesore në drejtim të Dejnës është i papërshtatshëm për mjetet që kalojnë në atë segment, konkretisht për kamionët që bëjnë bartjen e zhavorrit në atë pjesë. Kështu që çasja aktuale e rrugës Valon Hoti me rrugën kryesore është e papërshtatshme dhe kthesë shumë e madhe dhe vazhdimisht ka shkaktuar telashe dhe ka pasur edhe aksidente që ka ndodhur edhe janë rrotulluar kamionët e zallit aty dhe kanë rrezikuar të futen në objektet që janë përgjatë asaj rruge. Kërkesa e banorëve është të behet një aneksim në atë rrugë dhe të krijohet një çasje më e lehtë e kamionëve diku në afërsisht 10-15 gjatësi ose në asfalt apo në kubëza dhe do të evitonte rrezikun që paraqet ajo rrugë por gjithashtu edhe pluhurin gjatë kohës së vërës që shkaktojnë kamionët në atë pjesë e sigurisht edhe baltën që e shkaktojnë gjatë dimrit ata kamionë. Shpresoj që Drejtoria e Shërbimeve Publike ta shqyrtoj me urgjencë këtë çështje dhe t'i jep zgjidhje kësaj problematike.

**Fehmi Cena** – Përshëndetje për ju kryesues dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë desha me ngritë një çështje që në fakt e kemi ngritur edhe herëve tjera rreth subvencionimit të bujqve nga niveli qendror konkretisht nga Ministria e Bujqësisë. Këtë çështje e kemi ngritur edhe në mbledhjen e kaluar mirëpo na është thënë që në atë mbledhje kryetari i komunës dhe drejtori i Bujqësisë kanë pasur një takim me nivelin qendror konkretisht me ministrin e Bujqësisë, duke parë që kjo çështje po stërgjatët ku dihet se për vitin e kaluar nga subvencionimi për vitin 2020 pjesa e dytë, një numër i madh i bujqve ende nuk e kanë marrë subvencionin dhe me të drejtë ata ende janë të shqetësuar dhe pyesin vazhdimisht se çka është kjo çështje kështu që po stërgjatët dhe gjithashtu edhe për vitin 2021 ende nuk ka filluar aplikimi edhe pse e dimë që sipas rregullës është deshtë me filluar qysh më 15 shkurt. E di që kjo nuk është përgjegjësia juaj e qeverisë lokale mirëpo ju jeni ata që keni kontakte dhe komunikime direkt me qeverinë se ku ka ngecur kjo çështje, se a është arritur diçka brenda kësaj periudhe 1 muajore apo nga ai takim që keni pasur me përpara, sepse vërtet kjo nuk është në rregull duke ditur se subvencionimi duhet të behet qysh herët në pranverë duke ditur se qëllimi i subvencionimit është që të ndihmohen bujqit në start kur ata duhet me investua në bujqësi ndërkaq tash jemi në fund të muajit qershor dhe ka ngecur kjo çështje edhe e vitit të kaluar por edhe tash e këtij viti.

**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, të nderuar kolegë, përfaqësues të mediave dhe gjithë ju te pranishëm. Para se me kalua ne çështjen që e kam përgatitur për këtë seancë edhe unë e mbështes propozimin e kolegut Fehmi Hoxha. Unë i takoj asaj gjenerate që gjimnazin e kemi kryer nëpër objekte dhe shpija private dhe nëpër xhamia që janë mbi 4 apo 5 objekte këtu në qytet që i kemi graviturat dhe shpesh herë e di që pronarët e këtyre objekteve janë persekutuar nga regjimi i atëhershëm dhe nuk ka qenë fare e lehtë dhe besoj që institucionet sot lirinë që e gëzojmë duhet që kontributin e atyre që kanë sakrifikua për vazhden e arsimit të jenë të mirënjohur dhe të respektuar prej institucioneve. Edhe çështja e dytë për të cilën dëshiroj të diskutohet është komisionet e kuvendit, pasi kuvendi me shume seriozitet i ka formua disa komisione për nevojat e qytetareve për shqyrtimin e lendeve të ndryshme dhe unë kam qenë për një kohë në komisionin për ankesa për emërtimin e rrugëve dhe shesheve publike, ku kemi shqyrtuar mjaft shume lëndë dhe kemi dorëzuar material tash e 5 muaj dhe asnjëherë nuk po vjen në rend dite në kuvend. Për mua kjo është shqetësuese se pse po neglizhohet kuvendi prej ekzekutivit, pasi që nëse materia e lëndës është e ndjeshme atëherë është e ndjeshme për vendimmarrje nga ana e asamblistëve e jo nga ana e kryetarit dhe ekzekutivit. Do të ishte mirë që një raport i dorëzuar prej komisionit të vije në kuvend dhe kuvendi të vendos për fatin e atyre lëndëve. Po ashtu është shumë shqetësuese për mua si kryesues i komisionit që kam qenë në komision që shpesh ka thirrje prej qytetareve që interesohen për fatin e kërkesës se tyre dhe nuk kemi asnjë përgjigje. Këtu kemi pasur edhe lëndë të natyrës shumë të lehtë që janë bërë gabime teknike me rastin e emërtimit të shenjave si p.sh. kuvendi ka vendosur për emërtimin e një rruge me emrin “Remzi Ukshini” kurse në teren është vendosur me emrin “Remzie Ukshini” d.m.th. nga gjinia mashkullore është kaluar në gjininë femërore dhe qytetarët janë të hutuar sa i përket këtij emri, por ka edhe raste të tjera kështu që komisioni me të drejtë ka vendos me i bo këto përmirësime dhe besoj që nuk duhet të neglizhohet kjo dhe duhet sa shpejtë të vij në kuvend dhe të vendoset në mënyrë meritore. Po ashtu edhe çështja e pagesës së komisioneve, pasi që nuk është në rregull që një komision të vonohet me ka 1 vit pagesa kur dihet se numri i asamblistëve që jemi shumë i vogël e kjo nuk i kushton komunës me buxhet në krahasim me rastin e arsimit që i kushton me një shumë të madhe. Kështu që besoj që do të adresohen këto dhe do të kryhen në një të ardhme të afërt.

**Kajtaç Berisha** – Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolegë kuvendarë, përfaqësues të mediave dhe gjithë ju te pranishëm në sallë. Kërkesa ime është edhe e banoreve të fshatit Drenoc që ajo mundësisht të jete emergjente që të vendosen disa pengesa rrugore apo polic te vdekur në rrugën kryesore gjegjësisht afër shkollës dhe qendrës së fshatit. Pastaj kërkesa tjetër është mirëmbajtja e kanaleve atmosferike në rrugën kryesore Drenoc-Rahovec pasi kur bjen shi i rrëmbyeshme atëherë ato kanale dëmtohen dhe duhet të bëhet mirëmbajtja tyre në aksin rrugor Drenoc-Rahovec.

**Sali Sallteku** – Përshëndetje për të gjithë. I pamë kërkesat që u parashtruan nga kuvendarët mirëpo pasi që tash erdhi edhe kryetari ju kisha lut juve kryesues edhe kryetarin që pasi që është vapë e madhe dhe jemi në temperatura mjaft të larta, duhet ta keni parasysh këtë dhe të mundësohet që mos të stërgjatët shumë kjo mbledhje e kuvendit.

**Fatmir Iska** – Përshëndetje për ju kryesues, i nderuar kryetar, drejtor, kuvendarë dhe gjithë ju te pranishëm. Në pyetjen e parashtruar nga asamblisti Fehmi Hoxha rreth vendosjes së pllakave në shtëpitë që dikur ishin shkolla në kohën e okupimit. Unë mendoj se kjo është një kërkesë e arsyeshme dhe me sa kujtoj ka qenë edhe një vendim prej qeverisë për kompensim sa do pak moral por edhe financiar të këtyre shtëpive shkolla. Unë nuk e di që është vendos deri me tash ndonjë pllakë në këto shtëpi shkolla por ndoshta mos është ndonjë ngatërrim që vendosen këto pllaka në shtëpi që dikur ishin shtabe të ushtarëve të lirisë. Ne jemi në proces të evidentimit në gjithë komunën e Rahovecit dhe pastaj do të merret në konsideratë që të vendosen dhe unë jam i pajtimit që të vendosen ato, për shkak se edhe vet kam qenë nxënës që kam frekuentue në një

shtëpi të vjetër të Sokolëve në Rahovec dhe gjithashtu ka qenë edhe Munib Durguti që ishte një gjeneratë para meje, kështu që jemi dakord rreth kësaj. Pastaj asamblisti Ali Morina rreth rrugës Valon Hoti në Ratkoc, pasi është një kërkesë që të rregullohet që të mos kemi telashe më tutje dhe nuk jam në dijeni që kryetari i fshatit a ka bërë kërkesë për këtë por besoj që drejtorja e shërbimeve publike duhet të pasqyrojë këtë dhe nëse ka vend dhe hapësirë që mund të rregullohet kjo, pasi është me një gjatësi shumë të shkurtër dhe ndoshta edhe me kontratat ekzistuese mund të kryhet me shpejt. Pastaj pyetja e parashtruar nga asamblisti Fehmi Cena rreth subvencionimit për bujqit nga ana e ministrisë, kjo edhe herën e kaluar është ngritur si çështje dhe jemi të vetëdijshëm se nuk është kompetencë e jona për subvencionet që i ndanë ministria e bujqësisë por kompetencë e jona është me u kujdes për bujqit apo fermerët e komunës tonë. Brenda këtij viti konkretisht më 26 prill, komuna e Rahovecit përkatësisht kryetari i Komunës i është drejtuar ministrit të bujqësisë me një kërkesë se pandemia po vazhdon dhe kemi kërkuar prapë dyfishim të subvencioneve siç ka ndodhur në vitin 2020 dhe jo veç që nuk kemi pasur përgjigje për këtë kërkesë por kemi edhe mungesë të pagesës së bujqve apo fermerëve të pagesës së dytë për vitin 2020, që në mesin e tyre jam edhe unë jam njeri prej tyre, që realisht janë mbi 600 fermerë që nuk e kanë marrë këstin e dytë apo pagesën e dytë të subvencionimit. Pra kryetari i komunës së bashku me drejtorin e bujqësisë janë takuar para disa javësh me ministrin e bujqësisë dhe ende nuk kemi asnjë konfirmim nga ana e tyre. Ata me siguri janë duke i bërë analizat të thirrjes publike ndoshta analiza të formatit të ri të thirrjes por ende asgjë konkrete që neve na qet në dyshime se a do të ketë për këtë vitë thirrje publike për aplikim për fermerë. Kështu që deri më tani na paraqitet kjo gjendje në bazë të informatave që kemi si komunë. Po ashtu edhe asamblisti Munib Durguti ka parashtruar pyetjen e njëjtë rreth pllakave shtëpi shkolla dhe vetëm e dhamë përgjigjen me herët, pastaj tek pagesat për komisionet e kuvendit, ne kemi diskutuar jo me larg se javën e kaluar me drejtorin e financave kështu që jemi në proces të komisionit që nuk janë paguar dhe ato komisione që nuk janë paguar do të paguheshin shumë shpejt ndërsa sa i përket raportimit në kuvend të komisioneve parlamentare pasi ti kenë përfunduar ato punë, meqenëse nuk jam marrë shumë me këtë punë nuk e di se deri ku ka shkuar procesi, por sido që të është rregull e ekzekutivit që të gjitha ato raporte nëse kërkojnë prapë aprovim qoftë komisione për ankesa apo komisione tjera që formohen nëse kërkojnë aprovim prapë përsëri prej kuvendit duhet të sillen në kuvend dhe unë jam dakord për këtë. Pastaj tek asamblisti Kajtaz Berisha, unë besoj që drejtori i shërbimeve publike Përparim Krasniqi mundet me ju përgjigje rreth kësaj. Po ashtu edhe asamblisti Sali Sallteku që me pas pasqyrojë të nxehtin që mbledhja të mos zgjatet shumë, atëherë edhe në pajtohemi që me krye sa me shpejt.

**Përparim Krasniqi** – Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetar dhe gjithë të pranishmit. Sa i përket pyetjes së parashtruar nga Kajtaz Berisha rreth vendosjes së pengesave në rrugë, do të ishte mirë me bo një kërkesë zyrtare kryetari i fshatit në drejtorinë e shërbimeve publike për vendosjen e pengesave, ndërsa aprovimin final e bënë drejtorja e Financave për shkak se menaxheri i projektit është drejtori Afrim Limani, dhe me pastaj do të shohim se në sa vende do të vendosen ato pengesa. Ndërsa sa i përket hapjes së kanaleve, do të shohim mundësinë në pjesën e rrugës nëse ka lëshesa ujore në mund ta bëjmë hapjen e kanalit por me sa di unë nuk ka lëshesa ujore dhe nëse bëjmë hapjen e kanalit dhe uji rrinë apër pjesën e naltë nëse nuk depërtojmë në pjesën e poshtme. Por sidoqoftë ne do të dërgojmë një ekip të inxhinierëve dhe do ta shqyrtojmë mundësinë në ato pozicione që ka ngushtica apo pengesa dhe besoj që do të japim një përgjigje zyrtare.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë drejtor, të nderuar kolegë kuvendarë kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

### **3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021 – 2024.**

**Afrim Limani** – I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, të nderuar ju asamblistë dhe gjithë të pranishmit në sallë. Para se me ju shpjegua buxhetin, vlerën e buxhetit dhe krahasimin ndër vite kryesisht për vitin

2021, atëherë me lejoni që të ju them disa informata për KAB-in komunal. Rreth KAB-it komunal kemi pasur kohën dhe hapësirën e mjaftueshme për përgatitjen e këtij dokumenti që ne e quajmë strategjik për Komunën e Rahovecit, ku në mënyrë të saktë dhe precize janë të përshkruar të gjitha strategjitë dhe objektivat e sektorëve pra drejtorive, pastaj një analizë e saktë e planifikimit të të hyrave ndër vite 2022 – 2024 si dhe planifikimi i buxhetit 2022 nëpër kategori si dhe projeksionet nga viti 2022-2024. KAB-i komunal përmban edhe disa shënime tjera statistika dhe analiza që reflekton drejtpërdrejtë ndikimi i politikës makroekonomike në komunën tonë dhe gjithashtu edhe në fund të këtij dokumenti ne si komunë i kemi paraqit edhe disa shënime për barazinë gjinore që pak komuna e kanë bërë këtë veprim, ku janë të përshkruara në mënyrë të saktë gjendja e ndikimit në buxhet e gjinisë femërore në kuadër të institucioneve. Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2022 në total është 15,053,660 euro. Në kuadër të grandit të përgjithshëm kemi 5,761,000 euro, Këshilli i Hoçës Madhe 25,153 euro, grandet qeveritare 5,786,186 euro, të hyrat vetanake janë 1,356,000 euro dhe në total 15,053,660 euro dhe nëse bëjmë një krahasim të buxhetit të vitit 2022 në krahasim me vitin aktual pra 2021, kemi një ndryshim pozitiv me vlerë prej 837,070 euro. Kjo rritje është në kuadër të grandit të përgjithshëm prej 327,327 pastaj këshilli i Hoçës së Madhe prej 125,000, të hyrat vetanake janë 289,455, që në total i bien prej 837,070 euro. E veçantë e kësaj qarkore që vazhdimisht është ngritur një problem apo shqetësim nga ana e juaj është planifikimi i vogël i të hyrave vetanake deri në vitin 2021 dhe tash në bazë të kërkesave tona që i kemi adresua vazhdimisht në departamentin e buxhetit, konsideroj që planifikimi i të hyrave vetanake prej 1,350,000 është realisht i saktë dhe përputhet në bazë të inkasimeve që ne i kemi bërë dhe kemi mundësinë që planifikimin në kategori ekonomike ta bëjmë afërisht në mënyrë të saktë. E dini edhe ju se këto limite apo tavanet, planifikimin na cakton ministria e Financave që vetëm tatimin në pronë dhe tatimin në tokë e kanë vlerën mbi 700,000 euro dhe të hyrat tjera taksat janë mbi 630,000 euro, kështu që të dyja së bashku e përbëjnë shumën prej 1,350,000 euro. Po ashtu desha me ju dhanë edhe një informatë, sa i përket numrit të nxënësve edhe këtë vit kemi një zvogëlim të numrit të nxënësve në krahasim me vitin 2021 diku kemi afërisht 417 nxënës. Kështu që kur e bëjmë një krahasim nga viti 2020 atëherë numri i zvogëlimit të nxënësve është afërisht 1000 nxënës. Këtë informatë e dhashë sepse kjo drejtpërdrejtë ndikon dhe ka reflektim financiar dhe ndikon në buxhet sepse sipas analizave tona apo sipas formulës në përpjesëtim që është 21.3 një mesatare standarde atëherë i bie që pa punë do të mbesin brenda këtij viti 19 mësues. Ky dokument sipas qarkores buxhetore që e kemi analizuar edhe ju, do të duhet të votohet apo të aprovohet nga kuvendi dhe pres nga ana e juaj që ta votoni.

**Fehmi Hoxha** – Faleminderit kryesues, edhe unë pajtohem me kolegun tim që të shpejtohet mbledhja për shkak të nxehtësisë mirëpo megjithatë ne jemi këtu për me i diskutua disa çështje aty ku kemi mendime, vërejtje, sugjerime, propozime etj. prandaj në këtë rast unë do të jem i shkurt dhe nuk do të futem në elaborime të KAB-it pasi që është qarkorja e parë buxhetore dhe do të kemi kohë edhe për me vonë. Mirëpo tani do të ndërlihem me një çështje që ka qenë iniciativë shumë e mirë e komunës për punimin e muraleve për këtë vit dhe atë nga pozicioni i investimeve kapitale që nuk kanë mundur me u bë pasi që nuk lejohet nga investimet kapitale. Prandaj propozoj që kur të na vije qarkorja e dytë buxhetore nga pozicioni i mallrave dhe shërbimeve të ndahen për çdo vite nga 100,000 euro për punimin e muraleve që do të zhvillohen përmes konkursit të projektimit. Pasi që Rahoveci ka ecur dhe është duke ecur përpara në aspektin e kulturës përpos sportit që jemi krenar, mirëpo e mora shembullin pasi secili prej juve keni shkuar edhe Ferizaj dhe qytete tjera dhe qyteti i Ferizajit është bërë kampion i muraleve në nivel të Ballkanit, kështu që pse edhe ne nuk shkojmë në rrugën e tyre, kështu që e kemi përmes konkursit të projektimit e kemi shumë më lehtë me i zhvillua edhe procedurat përmes zyrës së prokurimit, prandaj 100,000 euro të

planifikohen që kur te vjen qarkorja e dytë buxhetore që të planifikohen qoftë në drejtorinë e kulturës apo të urbanizmit dhe të fillojmë edhe ne që ta zbukurojmë qytetin dhe komunën tonë.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin për financa për këtë material që na ka përgatitë për KAB-in dhe kjo është materia e parë që e kemi pra Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024 e cila përfshin planifikimin e buxhetit në vitin 2022 dhe parashikimin për dy vitet e tjera të ardhshme. Edhe kjo kornizë është përgatitur në bazë të qarkores së parë që edhe na e kemi, që limitet sikurse e tha edhe drejtori janë pak me të larta për planifikim pasi edhe buxheti është pak më i lartë dhe ne i gëzohemi kësaj pasi edhe granti qeveritar është pak me i lartë dhe po ashtu edhe te hyrat vetanake pra planifikimi është diçka që kemi kërkuar edhe me herët që te jetë pak me i lartë. Pastaj, shifrat që i ceku drejtori nuk dua me i përsërit tani dhe pjesa me e madhe e buxhetit rritje që ka po shkon në investime kapitale dhe një pjesë në paga dhe mëditje. Mirëpo nëse i referohemi qarkores së parë buxhetore dhe këtë çështje e kam ngritur edhe në komitetin për politike dhe financa në mbledhjen që kemi pasur, aty ceket se gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2022-2024 të këtij KAB-i të merren parasysh edhe obligimet që dalin prej kontratës kolektive, që është një çështje që e kemi ngritur edhe me herët dhe çështje që ballafaqohen qytetaret tanë të disa kategorive e sidomos shëndetësia, arsimit dhe komuna ju ka mbetë borxh këtyre punëtorëve. Ne kemi diskutuar disa here dhe e dimë që kontratat kolektive janë të nënshkruara nga niveli qendror mirëpo sa e dimë gjithashtu se komunat e kanë marrë këtë obligim me krye ndaj qytetareve. Sigurisht se kjo është e zorshme edhe drejtori e ceku se komuna e Rahovecit ka borxh në bazë të kontratës kolektive dhe në bazë të këtyre obligimeve 2 milion euro, pra është një shumë vërtet e madhe mirëpo sikur kjo të kishte ecur si proces që nga viti 2015-2016 kur janë bërë këto kontratat kolektive me siguri kjo nuk do të ishte kjo si problematikë. Por sidoqoftë kjo është materia e parë dhe në parim nga ne kërkohet ta aprovojmë kornizën afatmesme buxhetore, sigurisht se këtë planifikim do ta aprovojmë mirëpo kërkojmë që në fazat tjera të përgatitjes së KAB-it të përfshihet edhe ky obligim që ka komuna dhe duhet ta planifikoni. E di që borxhi është shumë i madhe mirëpo le të jetë në periudha sepse e dimë që një pjesë e qytetareve të këtyre kategorive e arsimit shëndetësia që shkojnë përmes linjës ligjore pra gjykatave dhe sigurisht se ata po e fitojnë kontestin kurse të tjerët që nuk shkojnë përmes gjykatave presin këtë të drejtë ta gëzojnë përmes vijës së drejtë që do të duhet të jetë përmes komunës. Prandaj unë kërkoj që ne të ardhmen gjatë planifikimit të bëhet diçka në këtë drejtim dhe të bëhet planifikimi i këtyre obligimeve që dalin nga kontratat kolektive. Kështu që në parim mendoj se duhet ta miratojmë këtë kornizë në këtë fazë.

**Afrim Limani** – Faleminderit për pyetjet e parashtruara, në pyetje që bëri Fehmi Cena të njëjtën e keni parashtruar edhe në mbledhjen e komitetit për Politike dhe Financa që e kam dhënë një shpjegim por edhe tash para kuvendarëve po e përsëriti. Zakonisht është procedurë e rregullt sipas ligjit të financave publike dhe përgjegjësi, para qarkores së parë buxhetore tubohet komisioni për planifikim të buxhetit, ku janë 3 komuna që zgjedhën me short e njëkohësisht janë edhe akteret qeveritare gjegjësisht ministria e financave shëndetësisë dhe arsimit. Në si komunë e kemi adresuar një kërkesë por edhe shumë komuna tjera pasi që të njëjtin problem e kanë edhe shumë komuna që zbatimi i kontratës kolektive pjesa e buxhetit të futet në planifikim të buxhetit dhe të krijohet një hapësirë e mirë edhe për shlyerjen e këtyre obligimeve. Kështu që realisht kjo ska ndodhur dhe ne nuk kemi mënyrë tjetër sepse planifikimi e buxhetit duhet me bo në bazë të limiteve të qarkores së parë buxhetore. Pastaj në këtë rast jemi në një situatë shumë të keqe dhe pafavorshme që ditëve në vijim gjykata apo përmbaruesi me i marrë këto mjete ku mundet me i gjete. Pra nuk kemi mënyrë tjetër, e kjo bëhet përmes planifikimit të buxhetit në nivelin qendror dhe në si organizatë buxhetor pra si komunë nuk kemi mundësi me bo këtë. E kemi edhe një mundësi siç e thash edhe në fillim se duhet të planifikohet buxheti për këtë, pra e kemi procesin e ridestinitimit që është ka muaji tetor dhe nëse eventualisht kemi mbetje në kategori të ndryshme p.sh. në kategorinë e sektorit të pagave apo mallrave dhe

shërbimeve atëherë ne kemi menduar apo kemi bërë një planë që te paktën edhe nëse na lejojnë kuptohet pasi që duhet me adresua kërkesë ne Ministrinë e Financave që sado pak me zbutë situatën por përndryshe nuk kemi asnjë mundësi tani për tani. Mundësitë tjera janë nga niveli qendror përmes procesit të rishikimit me bo këtë planifikim dhe pastaj përmes procesit të ridestinimit që është e përcaktuar me ligjin e financave publike dhe përgjegjësive që është ne muajin tetor. Ndonjëherë nuk po e kuptoj pasi që ne si komunë nuk jemi akter që kemi lidhur një marrëveshje, pasi që marrëveshja është lidhur përmes qeverisë dhe ministrinë e arsimit dhe të shëndetësisë, kështu që palët për ankesat e tyre duhet të adresohen tek akterët dhe jo ne si komunë. Kështu që ne e kemi analizuar mirë kontratën kolektive dhe është një nenë aty që përcaktohet saktë që ku duhet të adresohet pala, pra te akterët që e kanë nënshkruar marrëveshjen. Për mua është e pakuptueshme dhe besoj që edhe për juve që ne momentin e nënshkrimit të një marrëveshjeje, pasi që çdo marrëveshje që nënshkruhet dhe që ka reflektim financiar duhet të planifikohet me buxhete, pra mundësitë e komunës janë këto dhe tash po presim për me tutje. Vitin e kaluar e kemi pasur të planifikuar në kuadër të investimeve kapitale këtë projekt që e potencove ti mirëpo ne bazë të udhëzimit të ri që u dal nga ministria e financave nuk ka kalua ky projekt, por edhe ne e kemi paraparë që ne planifikimin për vitin e ardhshëm të futet gjithësi ky projekt por do të shohim mundësinë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për të gjitha sqarimet, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim ne votim. Konstatohet se me një votë kundër aprovohet pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

#### **4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit të Komunës për 6-mujorin e parë të vitit 2021.**

**Kryetari** – Faleminderit i nderuari kryesues, anëtare të kuvendit, përfaqësues të mediave dhe gjithë ju të pranishëm dhe faleminderit për votimin e kornizës afatmesme buxhetore 2022-2024. Ju e dini që është dokument që buron nga Ministria e Financave dhe paska ishte e çuditshme vota kundërt e Ali Zhuniqit. Pra është dokument që realisht limitet apo kufijtë buxhetorë caktohen në qarkoren buxhetore dhe qarkoren numër 1 e sjell ministria e financave dhe kjo është rregull. Unë po e prezantoj raportin në 6 mujorin e parë të vitit 2021, ku ky dokument përmban fjalën hyrëse, pastaj përmban vizionin që zakonisht është parimor dhe prioritetet sikurse edhe plani i punës për vitin 2021 që janë dokumente të cilat kanë kaluar në njëfarë mënyre dhe ju kanë nënshtruar edhe diskutimeve në kuvend të komunës. Raporti përmban të gjitha raportet e zyrave të kryetarit, si i zyrës ligjore, zyrës së personelit, zyrës së auditimit të brendshëm, zyra për barazi gjinore edhe raportet e drejtorive veç e veç siç është edhe raporti i zyrës komunale për komunitete dhe kthim. Ky raport është publikuar edhe në webfaqen zyrtare të komunës edhe sigurisht se është transparent për publikun dhe i hapur për lexim por edhe raportet veç e veç të secilës drejtori do të publikohen në webfaqen zyrtare dhe do të jenë me të detajuara dhe versioni i zgjeruar i raporteve të drejtorive veç e veç. Edhe gjat kësaj periudhe jemi ballafaquar me pandeminë Covid-19 dhe është lajm i mirë që kemi zero raste pozitive në Komunën e Rahovecit dhe jemi prej komunave të para që nuk e kemi asnjë rast, pasi që deri ditën e djeshme janë 5155 të vaksinuar dhe është një arritje edhe fale përkushtimit, gatishmërisë dhe mënyrës se si funksionojnë 5 ekipet tona në 5 dhomat në kuadër të objektit të QKMF-së. Ne jemi ballafaquar me pandeminë edhe gjatë këtij 6-mujori edhe kemi pas edhe kufizime siç kemi pasur edhe veprime dhe aktivitete të caktuara. Unë nuk dua të zgjatem me shumë rreth raportit pasi veç e keni para jush dhe është webfaqen e komunës raporti i punës së kryetarit dhe qeverisë komunale dhe natyrisht se ne kemi edhe pjesën e dytë të 6-mujorit dhe sigurisht se ka shumë angazhime gjatë këtij 6-mujori dhe ka edhe sfida natyrisht edhe dobësi por ka edhe rezultate të prekshme në komunën tonë. Ndoshta vlen me veçue se kemi nënshkruar grantin prej 406,989 euro që e ka fitua komuna jonë pasi është renditur e dyta në shkallë republike dhe ai grant tash ka fillua me u aplikua në përputhje me kërkesat specifike që i kemi bërë neper kode dhe projekte investive. Pres komentet juaja, vërejtjet sugjerimet plotësimet pasi ju e dini që nuk votohet raporti mirëpo për çfarëdo që keni jam i hapur bashkë me drejtorët e drejtorive me dhanë ndonjë

sqarim detaj koment apo përgjigje sipas rasteve kërkesave apo shqetësimeve që ju mundeni me i ngritë dhe ne jemi gati.

Kryesuesi – Faleminderit shume kryetar per prezantimin e raportit, te nderuar kolegë kalojmë ne pikën e pestë te rendit te ditës:

#### **5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal për Komunën e Rahovecit 2021 – 2025.**

**Artan Asllani** – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, anëtar te kuvendit dhe gjithë ju te pranishëm. Para jush e keni materialin për draft strategjinë për zhvillimin ekonomik lokal për Komunën e Rahovecit për vitin 2021-2025. Nëpërmjet procedurave te prokurimit publik komuna e Rahovecit ka kontraktuar një kompani profesionale për te bërë draft strategjinë për zhvillimin ekonomik për komunën e Rahovecit. Kontribut te veçantë kanë dhanë të gjithë drejtorët e drejtorive dhe zyrtarë te drejtorive. Plani strategjik për zhvillimin ekonomik lokal për komunën e Rahovecit për periudhën 2021-2025 është kornize kryesore strategjike që drejton vendimmarrjen brenda komunës dhe ndihmon ne përqendrimin e përpjekjes se komunës për te bërë realitet vizionin e saj. Rrjedhimisht kjo përcakton një standard shume te lartë te pritjeve dhe parametrave brenda qeverisë te cilave komuna duhet te ju ofroje shërbime ne mënyrë efikase dhe efektive për te gjithë qytetaret e komunës se Rahovecit. Rreth këtij materiali komuna e Rahovecit i ka zhvilluar te gjitha procedurat ashtu siç janë te përcaktuara sipas udhëzimit administrativ te ministrisë te pushtetit lokal. Qysh prej datës 12.04.2021 është publikuar për mbajtjen e mbledhjes se komitetit për Politike dhe Financa po ashtu është marre vendimi nga kuvendi i komunës se Rahovecit për shqyrtimin e debatit publik rreth kësaj strategjie. Me datën 02.06.2021 është mbajtur edhe debati publik me qytetaret për konsultimin ku kanë marr pjesë qytetaret e komunës se Rahovecit ku janë shqyrtuar dhe analizuar te gjitha komentet rreth këtij dokumenti. Andaj te nderuar kuvendarë, pres nga ana e juaj që ta votoni këtë material rreth strategjisë se zhvillimit ekonomik lokal për vitin 2021-2025.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume drejtor për prezantimin, po është e vërtet se drejtorët kanë dhënë kontribut rreth strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal por gjithashtu kanë dhënë edhe qytetaret e komunës tonë e ne mesin e tyre edhe kryesuesi i Kuvendit. Gjithsesi ne komitetin për politike dhe financa e kemi trajtuar hollësisht edhe i kemi rekomandua kuvendit duke ditur që strategjia i ka kaluar te gjitha procedurat ligjore. Atëherë nëse dikush nuk ka diçka rreth kësaj, e qesim ne votim pikën e pestë te rendit te ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e peste e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e gjashtë te rendit te ditës:

#### **6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit te kryetarit për shpalljen me interes te pergjithshëm publik P-7151005-01054-0 në zonën kadastrale Krushe e Madhe.**

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, te nderuar kolegë drejtor, anëtarë te kuvendit. Para jush keni vendimin e kryetarit te komunës për shpalljen me interes e pergjithshëm publik P – 715005-01054-0 ne zonën kadastrale ne Krushë të Madhe, e cila është prone shtetërore e Kosovës KK. Rahovec e evidentuar si ujërat me sipërfaqe prej 6.48m<sup>2</sup>. Qëllimi i shpalljes se interesit te pergjithshëm është rregullimi i parkut ne qendër te fshatit Krushë të Madhe e cila do te shërbej për rekreacion dhe lëvizje të lirë të qytetarëve në Krushë të Madhe dhe me gjerë. Po ashtu një arsye tjetër shume te madhe se kjo është se KRU. Gjakova ka pretendime ndaj kësaj parcele dhe ka përgatit padi penale për vërtetimin e pronësisë. Kërkoj nga ju që pas shqyrtimit të aprovonit propozim vendimin e kryetarit te Komunës për shpalljen me interesit e pergjithshëm.

**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, kemi bërë shume debate se a kemi te drejtë me futë ne rend te ditës një lëndë te tillë ku kërkohet shpallje me interes te pergjithshëm e sidomos tash pas shpalljeve te zgjedhjeve lokale, kështu që unë kisha kërkuar një sqarim prej zyrës ligjore që me na i lexua nenët dhe ligjet për pronësi, që me pae se a kemi te drejtë apo nuk kemi te drejtë me vendos sa i përket kësaj lënde meqenëse tash zgjedhjet lokale janë shpallur.

**Isak Hoti** – Përshëndetje kryesues, drejtor, delegat të kuvendit dhe gjithë ju të pranishëm. Shpallja me interes të përgjithshëm publik nuk është e përcaktuar në ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale. Kështu që nuk kemi të bëjmë me dhënie të pronës në shfrytëzim për shpallje të interesit të përgjithshëm për interesin e qytetarëve, pra nuk ka të bëjë fare ligji për dhënien në shfrytëzim me shpalljen me interes të përgjithshëm publik.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Hoti për sqarimet, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar e qesim në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës. Konstatohet se me një votë abstenim aprovohet pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalohet në pikën e shtatë të rendit të ditës:

#### **7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozimit të vendimit për vënien në konsultim publik të Draft statutit për QKMF-në e Rahovecit.**

**Samir Mustafa** – Përshëndetje për të gjithë. Para jush kemi statutin e hartuar nga ministria e shëndetësisë, i cili është statut unik dhe në kemi pranuar qarkoren informative nga ministria e shëndetësisë me nr.04/2021, ku është formuar grupi punues për hartimin e statutit të QKMF-së. Andaj për hir të transparencës, kërkojmë nga ju leje për dalje në debat publik.

**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, e mirëpres këtë dokument është shumë me rëndësi që të zgjidhen ato dilema që kanë qenë me kohë dhe në kemi aprovuar një statut të vitit 2015 mirëpo jo në përputhje me kërkesat e plota të ministrisë, pasi kemi pasur dilema që kuvendi komunal ka të drejtë me aprovue një statut meqenëse është themelues i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe kohë pas kohë nuk është pranuar mirë prej ministrisë edhe e mirëpres iniciativën që përfundimisht ta kemi një statut të harmonizuar ministri dhe kuvend komunal. Ajo që dëshiroj me theksua në disa raste përmendet drejtoria komunale për shëndetësi ndërsa në disa raste përmendet drejtoria komunale për përkujdesje sociale. Kështu që do të ishte mirë me u harmonizua kjo para se me dal në debat publik dhe kur të del dokumenti për aprovim pastaj atëherë i japim ato propozime dhe sugjerime.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, edhe unë e përshëndes këtë iniciativë të drejtorit komunal të shëndetësisë, që me në fund një statut i QKMF-së që tentohet të jetë unik në nivel vendi i hartuar nga ministria e shëndetësisë të shqyrtohet në kuadër të kuvendit komunal dhe njëkohësisht të hidhet edhe në konsultim publik. Ky është një akt normativ i cili rregullon punën dhe gjitha çështjet në kuadër të shëndetësisë primare. Ashtu sikurse e etha edhe Munib Durguti se ka qenë një statut mirëpo nuk ka qenë shumë i kuptueshëm pasi ka pasur shumë ndërhyrje të shumta dhe nuk ka qenë unik në nivel vendi. Kështu që tash sa e di unë edhe pse është nga niveli qendror, në si komunë kemi të drejtë me u marr me disa propozime apo ndryshime diku deri në 10% sipas specifikave që i ka shëndetësia jonë sigurisht, pra ka nevojë për konsultim publik dhe gjithashtu ka nevojë edhe për një grup punues që tha edhe drejtori me herët por kështu me thënë profesional me tepër që me përvojën e tyre të punojnë në finalizimin e tij. Kështu që unë kërkoj që në mbledhjen përfundimtare të kuvendit komunal, drejtori bashkë me materialin e statutit me na sjell edhe një raport nga konsultat që do të bëhen në nivel publik por edhe nga grupi punues, në mënyrë që na të finalizojmë ashtu edhe më së miri të kompletojmë këtë statut.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Cena për kontributin, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim në votim pikën e shtatë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e shtatë e rendit të ditës. Kalohet në pikën e tetë të rendit të ditës:

#### **8. Shqyrtimi i Raportit të performancës komunale për vitin 2020.**

**Bjondina Rama** – Përshëndetje për ju kryesues, kryetarin, anëtarët e kuvendit dhe gjithë të pranishmit. Reportin për performancën komunale janar – dhjetor 2020 në bazë të udhëzimit për performancë komunale, komuna raporton për 19 fusha gjithsej. Udhëzimet e punës dhe qëllimet e prezantimit janë mbledhja verifikimi raportimi i të dhënave nga komunat në sistem elektronik. MAPL-ja i dërgon njoftimet me kohë, i përcjell te koordinatori pastaj koordinatori me anëtarët dhe në përgjithësi plotësohen të gjitha fushat. Kjo

është shumë me rëndësi me cekë se komuna raporton ne 19 fusha, autorizimin e të dhënave e bën kryetari i komunës ne bashkëpunim me drejtorët. Tash kohëve të fundit ka edhe shumë anëtarë të kuvendit që marrin pjesë në trajnimet që janë për performancë komunale, ku keni 19 fusha dhe për secilën fushë janë shpjegimet e të dhënave në mënyrë detale, kështu që nëse ka dikush diçka ne jemi këtu dhe mundemi me ju dhanë përgjigje.

**Kryesuesi** – Faleminderit zonja Rama për sjelljen e raportit në kuvend. Atëherë të nderuar kolegë kuvendarë, faleminderit shume për kontributin e dhënë dhe shihemi ne mbledhjen e radhës.

**Procesmbajtësi:**

---

**Agim Hoti**

**K R Y E S U E S I**

---

**Afrim Dina**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odaljenje za Opštu Upravu

III. Nr. I prot. 3485 Mb. 12.07.2021  
Br. prot. Dt. 20  
RAHOVEC - ORAHOVAC

Korrik 2021

# KOMUNA E RAHOVECIT DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Raporti financiar Janar-Qershor 2021

Drejtor: Afrim Limani

Përmbajtja

<b>HYRJE</b> .....	<b>2</b>
<b>1. TË HYRAT VETANAKE</b> .....	<b>3</b>
1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2021-2020 .....	3
1.2 Të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore 2021/2020 dhe krahasimi i tyre .....	3
1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2015-2021.....	3
1.4 Krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjambat e trafikut dhe gjambat nga gjykatat 2021/2020 .....	3
1.5 Përmbledhja e të hyrave të realizuara,të rregullta , gjambat e trafikut, gjambat nga gjykatat, të hyrat nga pyje 2021/2020 .....	4
1.6 Krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2021/2020.....	5
<b>2. TATIMI NË PRONË</b> .....	<b>6</b>
2.1 Planifikimi dhe realizimi i tatimit në pronë 2021/2020 .....	6
2.2 Shpërndarja e faturave, regjistrimet dhe verifikimet e objekteve në Tatimin në Pronë.....	7
<b>3. REALIZIMI I BUXHETIT</b> .....	<b>7</b>
3.1 Shpenzimet sipas programeve (drejtoritë) .....	7
3.2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike .....	8
3.3 Mallra dhe Shërbime sipas programeve .....	9
3.4 Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike .....	12
3.5 Shërbime Komunale .....	14

## HYRJE

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së përgjithshme, Shëndetësisë primare, Arsimit dhe Shkencë për periudhën Janar – Qershor 2021, duke përfshirë kategoritë ekonomike të pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.

Realizimin i të hyrave komunale-vetanake dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyre analitike, të hyrat nga gjobat e trafikut dhe të gjykatave si dhe krahasimi i tyre në raport me të njëjtën periudhë Janar-Qershor të vitit 2021/2020

Buxheti i Komunës për vitin 2021, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financës, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2021, për komunën e Rahovecit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
  - Shikimin e realizimit, respektivisht shpenzimin e mjeteve sipas kategorive (pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.
  - Mundësin e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive, se a është tejkaluar-shfrytëzuar apo nuk është shfrytëzuar fondi i planifikuar, alokuar.
  - Shprehja në përqindje e shfrytëzimit të buxhetit në periudhën vjetore.
- ❖ Në këtë mënyrë nga aspekti financiar është e arsyeshme të paraqitet:
- Realizimi i të hyrave vetanake-komunale sipas burimeve,
  - Shpenzimet e krijuara sipas kategorive buxhetore,
  - Përqindja e realizimit të buxhetit për këtë periudhë kohore.

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për paga, mallra & shërbime, shërbimeve komunale, subvencioneve, investimeve kapitale si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e thesarit të Ministrisë për Financa dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

## 1. TË HYRAT VETANAKE

### 1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2021-2020

Përshkrimi	Planifikimi 2021	Realizimi 2020	Realizimi 2021	Ndryshimi 2021-2020	Krahasimi 2021/2020
Të hyrat e rregullta	1,063,093.00	404,602.34	548,538.16	143,935.82	35,57%

**-Vërejtje:** në këtë tabelë të hyrat e realizuara për vitet 2020 dhe 2021 janë pa gjobat e trafikut dhe gjykatave.

### 1.2 Të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore 2021/2020 dhe krahasimi i tyre.

Periudha	Realizimi 2020	Planifikimi 2021	Realizimi 2021	Ndryshimi Realizimi/Planifikim 2021	Përqindja e Realizimit 2021/planifikim
Janar	73,433.20	88,424.42	79,206.53	(9,217.89)	(10.42)
Shkurt	90,756.67	88,424.42	85,381.57	(3,042.85)	(3.44)
Mars	80,321.71	88,424.42	116,898.68	28,474.26	32.20
Prill	19,328.99	88,424.42	107,245.33	18,820.91	21.28
Maj	27,181.24	88,424.42	81,201.86	(7,222.56)	(8.17)
Qershor	113,580.53	88,424.42	78,604.19	(9,820.23)	(11.11)
<b>Totali</b>	<b>404,602.34</b>	<b>530,546.52</b>	<b>548,538.16</b>	<b>17,991.64</b>	<b>51.69</b>

### 1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2015-2021.

Periudha	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Janar	59,440.11	53,093.33	65,258.72	71,296.21	67,441.16	73,433.20	79,206.53
Shkurt	63,104.60	72,122.01	53,970.89	79,441.98	101,728.36	90,756.67	85,381.57
Mars	73,504.67	107,024.34	123,917.27	100,586.69	77,787.87	80,321.71	16,898.68
Prill	55,312.19	92,147.11	67,409.06	74,037.40	88,525.55	19,328.99	107,245.33
Maj	59,445.79	60,471.16	86,337.92	64,983.12	90,937.21	27,181.24	81,201.86
Qershor	63,009.17	61,909.92	55,212.16	65,779.79	102,804.51	113,580.53	78,604.19
<b>Totali</b>	<b>373,816.53</b>	<b>446,767.87</b>	<b>452,106.02</b>	<b>456,125.19</b>	<b>529,224.66</b>	<b>404,602.34</b>	<b>548,538.16</b>

### 1.4 Krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjobat e trafikut dhe gjobat nga gjykatat 2021/2020

Gjobat e gjykatës baza mujore

Muajt	Gjobat e gjykatave 2020	Gjobat nga e gjykatave 2021	Ndryshimi 2021-2020	% 2021/2020
Janar	20.00	1,401.00	1,381.00	6,905.00
Shkurt	40.00	3,040.00	3,000.00	7,500.00
Mars	280.00	2,370.00	2,090.00	746.43
Prill	-	-	-	#DIV/0!
Maj	-	-	-	#DIV/0!
Qershor	270.00		(270.00)	(100.00)
<b>Totali</b>	<b>610.00</b>	<b>6,811.00</b>	<b>6,201.00</b>	<b>1,016.56</b>

## Gjobat në trafik në baza mujore

Muajt	Gjobat e trafikut 2020	Gjobat nga e trafikut 2021	Ndryshimi 2021-2020	% 2021/2020
Janar	20,595.00	20,025.00	(570.00)	(2.77)
Shkurt	18,945.00	20,626.00	1,681.00	8.87
Mars	12,216.00	29,333.00	17,117.00	140.12
Prill	1,610.00			(100.00)
Maj	5,465.00			(100.00)
Qershor	14,405.00			(100.00)
<b>Totali</b>	<b>73,236.00</b>	<b>69,984.00</b>	<b>3,252.00</b>	<b>(-4.44%)</b>


1.5 Përmbledhja e të hyrave të realizuara, të rregullta, gjobat e trafikut, gjobat nga gjykatat, të hyrat nga pyje 2021/2020

## Të hyrat e rregullta, Gjobat e Gjykatave, Gjobat në trafik, Të hyrat nga pyje 2021/2020

